



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 104
Prishtinë, më 8 dhe 12 mars 2013

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 dhe 12 MARS 2013

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ganimete Musliu, Teuta Sahatqija, Albana Gashi, Donika Kadaç-Bujupi, Myzejene Selmani, Myfera Shinik, Xhevahire Izmaqi, Hykmete Bajrami, Kymete Bajraktari, Emilija Rexhepi dhe Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Salihe Mustafa parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e pensioneve në vitin 2012 dhe vështirësitë eventuale gjatë këtij zbatimi.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Hashim Dëshiku parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me bazën ligjore për marrëveshjen e lidhur ndërmjet shtetit të Kosovës dhe shtetit të Maqedonisë lidhur

me realizimin e të drejtës në pension për qytetarët e të dyja vendeve që kanë punuar në shtetet respektive, për numrin e përfituesve nga Kosova dhe shumën vjetore të këtyre pensioneve që u paguhen nga Kosova dhe anasjelltas.

Ministri Nenad Rashediu iu përgjigj pyetjes së deputetit Hashim Dëshiraku.

Deputeti Goran Marinković parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me përfundimin e projektit për ndërtimin e largpërcësuesit të energjisë elektrike në komunën e Graçanicës.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se deri në cilën fazë kanë shkuar hetimet për vrasjen e Enver Zymberit dhe Selver Haradinajt.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Albana Gashi parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashediu në lidhje me atë se a janë duke i marrë personat e verbër dhe pjesërisht të verbër pagat për efekt verbërie, ashtu siç është paraparë me ligj.

Ministri Nenad Rashediu iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

Deputeti Halit Krasniqi parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat e parapara nga Ministria e Shëndetësisë për këtë vit, para se të fillojë sezoni i shfaqjes së epidemisë së rriqrave, kryesisht nga regjioni i Prizrenit me epiqendër në komunën e Malishevës dhe një pjesë të komunës së Drenasit dhe të komunës së Klinës, ku për një dekadë e kanë humbur jetën tridhjetë veta dhe me mijëra të tjerë janë hospitalizuar nga kjo epidemi.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me ndërtimin e rrugës nga Lugu i Baranit deri te Lugu i Leshanit.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Në vazhdim të punimeve, kryetari konstatoi se janë dy kërkesa lidhur me rendin e ditës:

1. Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, propozoi që në rend dite të futet pika - Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të gjashtë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel.

Kryetari më pas kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, deklaroi se nuk e përkrah kërkesën e kryetarit të GP të PDK-së, sepse një gjë e tillë nuk është urgjente dhe se grupi që ai përfaqëson do të votojë kundër kësaj kërkesë

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deklaroi se nuk e përkrah kërkesën e kryetarit të GP të PDK-së që raportimi i kryeministrit të Kosovës për takimin e gjashtë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel të bëhet në mbledhjen e sotme.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, deklaroi se nuk është e nevojshme që raportimi të bëhet në mbledhjen e sotme plenare.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, e përkrahu kërkesën e lartpërmendur të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Sasha Milosavljeviq, në emër të GP SLS, e përkrahu kërkesën e lartpërmendur të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Pas deklarimeve të lartshënuara, kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të PDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër----- 41,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se në bazë të nenit 51.6 të Rregullores së Kuvendit, kur kemi numër të barabartë të votave “për” dhe “kundër”, konstatohet se propozimi nuk është miratuar.

2. Deputetja Teuta Sahatqija, në emër të Grupit të Grave Deputete, propozoi që pikat e mbetura nga mbledhja e sotme plenare të shtyhen për një ditë tjetër, me arsyetimin se sot është 8 Marsi - Dita Ndërkombëtare e Gruas dhe se kanë një varg aktivitetesh të ndryshme për shënimin e kësaj dite.

Kryetari më pas kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetes Teuta Sahatqija.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, deklaroi se përkrah propozimin e deputetes Teuta Sahatqija.

Alma Lama, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetes Teuta Sahatqija.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, deklaroi se e përkrah propozimin e lartpërmendur të deputetes Teuta Sahatqija.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetes Teuta Sahatqija.

Duda Balje, në emër të GP “6+”, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetes Teuta Sahatqija.

Deklarimet e kryetarëve apo përfaqësuesve të grupeve parlamentare janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetares se Grupit të Grave Deputete, që pikat e mbetura nga mbledhja e sotme plenare të shtyhen për një ditë tjetër.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër----- 12,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se mbledhja e sotme përfundon me këtë pikë, ndërsa vazhdimi i mbledhjes plenare me pikat e mbetura do të bëhet të martën, më 12 mars 2013, në orën 10:00.

Kryetari i përfundoi punimet e mbledhjes plenare në orën 11:40.

* * *

E martë, 12 mars 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 8 mars 2013

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryesuesi e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 8 mars 2013.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 77 deputetë.

Në vazhdim të punimeve, kryesuesi konstatoi se janë dy kërkesa lidhur me rendin e ditës:

1. Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, propozoi që në rend dite të futet pika - Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të gjashtë, me kryeministrin e Serbisë në Bruksel.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartshënuar.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, deklaroi se e përkrah kërkesën e kryetarit të GP të PDK-së.

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deklaroi se nuk e përkrah kërkesën e kryetarit të GP të PDK-së.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, deklaroi se e përkrah kërkesën e kryetarit të GP të PDK-së.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, tha se e përkrah kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Petar Miletqi, në emër të GP SLS, tha se e përkrah kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Myfera Shinik, në emër të GP “6+”, tha se e përkrah kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Pas deklarimeve të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të PDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,
Kundër----- 12,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e GP të PDK-së që në rend dite të seancës së sotme të radhitet edhe raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të gjashtë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që pika e rendit të ditës - Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012 të hiqet nga rendi i ditës me arsyetimin se kjo pikë do të duhej të shqyrtohej në të njëjtën kohë me raportin e Komisionit për Ndryshime Kushtetuese.

Kryesuesi më pas kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Shaip Muja, në emër të GP të PDK-së, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deklaroi se përkrah propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Petar Miletij, në emër të GP SLS, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, deklaroi se e përkrah propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Pas deklarimeve të shënuara më lart, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me propozim të kryetarit të GP të LDK-së, e hoqi nga rendi i ditës pikën - Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,

4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të gjashtë me

- kryeministrin e Serbisë në Bruksel,
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit,
 6. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2013,
 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore,
 8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës,
 9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit,

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 28 shkurt dhe më 1 mars 2013, si dhe procesverbalin e mbledhjes së jashtëzakonshme më 1 mars 2013.

4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të gjashtë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta marrë fjalën.

Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, tha se në takimin e gjashtë në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili u mbajt në Bruksel, më 4 mars 2013, fillimisht delegacioni i Kosovës kishte një takim bilateral me baroneshën Eshton dhe ekipin e saj. Në këtë takim, baronesha Eshton shprehu përsëri konsideratën e saj të lartë për punën serioze dhe racionalitetin e lartë që ka dëshmuar delegacioni shtetëror i Kosovës gjatë gjithë këtij procesi.

Baronesha Eshton shprehu gatishmërinë e saj që të vijë së shpejti në Kosovë për të takuar liderët institucionalë dhe politikë, për t'i dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme për temat që janë duke u adresuar në kuadër të këtij procesi.

Kësaj radhe si pjesë e agjendës së takimit të gjashtë, baronesha Eshton, si ndërmjetësuese, insistoi që të diskutohet, ndër të tjera, për çështjen e themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Në këtë takim bilateral, delegacioni i Kosovës e ka theksuar edhe njëherë domosdoshmërinë se përfundimi i këtij procesi duhet të rezultojë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila do të nënshkruhet nga kryeministrat e të dyja vendeve - në cilësinë e garantuesit do të nënshkruhet nga baronesha Eshton, në emër të Bashkimit Evropian, dhe me mbështetje të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pas përfundimit të takimeve bilaterale ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe baroneshës Eshton, pasdite e filluam takimin e përbashkët për t'i diskutuar modalitetet për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe të Kosovës.

Ne e shprehëm gatishmërinë tonë për të mundësuar themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, në përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Ne kemi prezantuar në detaje strukturat që do të mund të kishte një asociacion i tillë, funksionin dhe detyrat që do të mund t'i ushtrojë brenda fushëveprimit të vet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale.

Unë dua ta ritheksoj faktin se struktura dhe funksioni i këtij asociacioni nuk mund të jenë ndryshe, krahasuar me asociacionin ekzistues të komunave të Kosovës.

Në rastin konkret, përveç fushave të veprimit që ndërliken me vetëqeverisjen lokale dhe në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, asociacioni i komunave me shumicë serbe mund të emërojë: një përfaqësues të vet për anëtarë të Bordit Zhvillimor për Veriun e Kosovës, i cili kuptohet që është një bord i përkohshëm; mund ta emërojë një përfaqësues të vetin për anëtar të Këshillit Konsultativ për Komunitete në kuadër të Zyrës së Presidentes së Kosovës; mund të mbajë kontakte ose të krijojë partneritete me asociacionet e ngjashme në Serbi dhe vende të tjera; mund t'i koordinojë ndihmat financiare që Serbia i dedikon për komunat me shumicë serbe në Kosovë, e të cilat duhet të jenë transparente dhe vetëm brenda kompetencave të komunave; mund të aplikojë për fonde të BE-së dhe mund të grumbullojë fonde tjera për nevoja të projekteve infrastrukturore në nivel të komunave të tjera.

Baronesha Eshton shprehu miratimin e saj për gatishmërinë tonë që duke e respektuar Kushtetutën dhe ligjet tona, duke e respektuar Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, ne jemi të gatshëm për themelimin e këtij asociacioni të ri.

Në anën tjetër, kryeministri Daçiq, i cili duket qartë përsëri se nuk kishte asnjë miratim apo autorizim për të arritur ndonjë marrëveshje në këtë çështje, fokusin e prezantimit të tij e kishte përsëri te mënyra e zgjedhjes së këtij asociacioni dhe te kompetencat ekzekutive që duhet të ketë ky asociacion.

Serbia, sipas kryeministrit Daçiq, dëshiron që asociacioni, apo siç Serbia preferon ta quajë 'bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë', të jetë një trup politik, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ka kompetenca ekzekutive.

Një propozim i tillë të Serbisë ne e kemi hedhur poshtë si tërësisht të papranueshëm dhe të parealizueshëm në shtetin e Kosovës.

Baronesha Eshton, pasi i dëgjoi diskutimet dhe pozicionet e Republikës së Kosovës dhe Serbisë, kërkoi një pauzë për të bërë përpjekje për t'i përmbledhur në letër çështjet kryesore që ndërliken me formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Pas pauzës, ne u takuam përsëri, kësaj radhe në formatin një plus tre nga të dyja palët. Ne si delegacion i Kosovës kemi qenë të gjithë. Në këtë pjesë të takimit, baronesha edhe në formë të shkruar një draft-dokument, i cili përmbledh parimet bazë për themelimin e asociacionit dhe funksionet apo detyrat që një asociacion i tillë do të mund të ushtronte.

Me bindje të plotë konfirmoj se draft-dokumenti i propozuar nga baronesha Eshton lidhur me krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovës është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Dëshiroj të ju siguroj se delegacioni i Kosovës me saktësi do t'i përmbahet vetëm mandatit të dhënë nga ju, nëpërmjet Rezolutës të miratuar për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Pas raportimit të Kryeministrit Thaçi, kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Bajrami, në emër të Grupi Parlamentar të PDK-së, tha se kur procesi po shkon drejt finalizimit është jashtëzakonisht me rëndësi që debatet në Parlament të jenë më të shpeshta dhe më gjithëpërfshirëse, sidomos në vigjilje të finalizimit të marrëveshjes. Të kyçen të gjitha partitë politike dhe ato ta japin kontributin e vet në këtë marrëveshje. Ky është një proces shtetëror, nuk është një agjendë qeveritare, nuk është një agjendë partiake, por një agjendë shtetërore, ku kërkohet edhe unitet, edhe vendosmëri, edhe një përgjegjësi e lartë.

Ai më pas u ndal në dy momente që i ngriti kryeministri në informatën e dhënë me këtë rast.

Momenti i parë ka të bëjë me finalizimin e këtij procesi me një marrëveshje ndërkombëtare të garantuar nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo marrëveshje të hartohet me kritere të larta profesionale, të shikohet detajisht, të shikohen elementet legale dhe kushtetuese, në mënyrë që të jetë plotësisht në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e Kosovës dhe t'i nënshtrohet sistemit kushtetues dhe legjislativ të Kosovës.

Momenti i dytë ka të bëjë me shpërbërjen e të gjitha strukturave jokushtetuese që veprojnë në pjesën veriore të Kosovës, filluar nga strukturat e sigurisë, krijimi i strukturave qeverisëse legjitime, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, funksionalizimi i sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe të gjitha segmentet tjera që i parasheh Kushtetuta e Kosovës, e që deri më tani nuk janë zbatuar në pjesën veriore për shkak të cenimit të integritetit, që e ka bërë Serbia.

Më pas, ai u ndal në çështjen e asociacioneve të komunave, për të cilin tha se ky mekanizëm ka bazë legale në pakon e ligjeve të qeverisjes lokale në konceptin dhe Pakon e Ahtisarit, por edhe në praktikën evropiane, duke insistuar që ky asociacion të themelohet dhe të funksionojë brenda pakos legjislative të Kosovës dhe brenda praktikave të mira evropiane për qeverisje lokale.

Parimet e funksionimit të asociacionit të komunave për të cilin po diskutohet në Bruksel duhet të jenë të njëjta me parimet e funksionimit të asociacionit të komunave shqiptare.

Ismet Beqiri, në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së, tha se nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga ajo që herën e kaluar kemi dëgjuar në këtë Kuvend, dhe se nuk kemi nevojë të moralizojmë, në kuptimin e asaj se s'ka diçka të re që ne do të duhej të thoshim, e që nuk e kemi thënë.

Grupi Parlamentar që ai përfaqëson qëndron në atë se çështjet që kanë të bëjnë me normalizimin e marrëdhënieve, të bëhen me dialog, por që kjo në asnjë rrethanë nuk nënkupton që të shkelen sovraniteti dhe integriteti, tërësia territoriale e vendit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe Rezoluta e miratuar në këtë Kuvend.

Edhe herën e kaluar, edhe sot, e përsëris që asociacioni i komunave me shumicë serbe si asociacion është i normuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, kjo nuk është ndonjë urgjencë dhe se mund të bëhet pasi të mbahen zgjedhjet atje. Por presioni nuk duhet të nënkuptojë që edhe ne të pranojmë dosido çfarëdo asociacioni në kuptimin e kompetencave.

Ne nuk do ta përkrahim asociacionin, i cili del jashtë asaj që e përcakton Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, asociacion i cili eventualisht në çfarëdo mënyre e cenon sadopak Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, po ashtu edhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, theksoi ai.

Arsye tjetër që nuk e shohim që ky asociacion është i dobishëm bazohet në faktin se gjithë politika e këtij vendi, vendore dhe ndërkombëtare, ka qenë e angazhuar për integrim të komunitetit, në këtë rast atij serb, në jetën institucionale dhe me krijimin e këtij asociacioni sikur po e bëjmë të kundërtën.

Ai e përsëriti edhe një herë kërkesën që ky asociacion të mos ketë kompetenca legislative, aq më pak ekzekutive dhe që çdo marrëveshje e arritur të vijë dhe të ratifikohet në këtë Kuvend.

Glauk Konjufca, në emër të Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se negociatat që po zhvillohen ndërmjet kryeministrit Thaçi dhe Ivica Daçiçit, përveç që po e çojnë Kosovën drejt thellimit të ndarjes, përbëjnë edhe negociatat më jotransparente që kanë ndodhur ndonjëherë në këtë vend. Ato janë edhe më të fshehta bile se negociatat e Vjenës, sepse në Vjenë të paktën dilnin dokumente të caktuara, të cilat binin në dorë të medieve, e pastaj publikoheshin dhe kështu mund t’i lexonin qytetarët dhe ta dinin më saktësisht se çfarë po ndodh me vendin e tyre.

Ai me këtë rast shtroi tri pyetje, lidhur me këto bisedime.

E para, a do të ishte krijuar ky asociacion i komunave serbe po të mos kishte qenë kjo ide në platformën e Serbisë për Kosovën? Sepse po të ishte kjo punë qejfi dhe për të mirën e Kosovës, me siguri që Qeveria jonë nuk do ta kishte pritur Serbinë për të dhënë ide kaq të mira.

Pyetja e dytë: Pse Serbia të na tregojë neve si shtet se në çfarë mënyrë duhet të jenë të rregulluara asociacionet tona të komunave. Nëse kjo qenka çështje veç e Kosovës, atëherë pse të dialogohet me Serbinë kjo punë? Pse Serbia të na tregojë që t’i kemi dy asociacione të komunave?

Dhe, pyetja e tretë: Nëse ky asociacion i komunave, siç po thotë kryeministri dhe kjo Qeveri, i ka kompetencat e asociacionit aktual të komunave, këtij asociacioni që e kemi në aktualisht, atëherë pse të mos funksionojë brenda këtij asociacioni. Kompetencat qenkan të njëjta! Qenka asociacioni i njëjtë! Pse, të krijohen dy trupa?

Më tej, ai e elaboroi çështjen e formimit të këtij asociacioni, ndërsa theksoi se logjika që institucionet në Kosovë të dyfishohen me bazë etnike është shumë e dëmshme dhe antishtetërore për shtetin e Kosovës dhe marrëveshja që do të rezultojë nga këto bisedime do të jetë edhe më e keqe se sa Plani i Ahtisarit.

Kjo logjikë është, siç tha ai, sikur të thuhet njëjtë, ky asociacion i komunave duhet ta ketë edhe policinë e vet dhe mos u frikoni se policia do t’i ketë të njëjtat kompetenca me Policinë e Kosovës.

Në fund, deputeti Glauk Konjufca theksoi se Qeveria e Kosovës është pajtuar që strukturat e shëndetësisë, të arsimit, të fushave tjera, do të vazhdojnë të punojnë me ligje të Serbisë, arsimit do të funksionojë nëpërmjet teksteve mësimore të botuara në Beograd. Por, do të bëjmë marrëveshje që pjesëtarët e MUP-it dhe strukturave tjera kriminale të sigurisë, që po kontrollohen nga Beogradi të bëhen mekanizëm që siguron asociacionin e komunave që do të krijohen.

Ardian Gjini, në emër të Grupi Parlamentar të AAK-së, tha se që asociacioni i komunave i cili krijohet në bazë të ligjeve që i kemi, nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe definitivisht se nuk do të ketë kompetenca legislative, të cilat do të ishin më problematike.

Nga ajo që ne po shohim është se në bisedimet në Bruksel ka dy lloj planesh, për vendin tonë fqinj.

Çështja e parë është normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën dhe çështja e dytë është avancimi i marrëdhënieve me Unionin Evropian.

Në vazhdim, ai tha se ne si shtet i Kosovës duhet të punojmë më shumë për avancimin e marrëdhënieve me Unionin Evropian dhe ajo fjali, që e tha kryeministri që ka të bëjë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse duhet të fillojë të qartësohet, cila është ajo pjesë tjetër, përpos normalizimit eventual të marrëdhënieve me Serbinë, që do t'i avanconte marrëdhëniet e Kosovës me Unionin Evropian.

Në fund, ai tha se për subjektin politik që ai përfaqëson është jashtëzakonisht me rëndësi, që avancimi i marrëdhënieve të Kosovës me Unionin Evropian, të shihet edhe si pjesë e një marrëveshjeje.

Myzejene Selmani, në emër të Grupi Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se kryeministri e përfaqëson Kosovën edhe në bazë të Kushtetutës, edhe në bazë të Rezolutës, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Në vazhdim, ajo tha se nga raportimi i kryeministrit po vërehet se çështja e bisedimeve është kah fundi i finalizimit të marrëveshjeve, marrëveshje të cilat do të jenë të garantuara nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në fund, ajo shfaq bindjen se finalizimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, të garantuara nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, të jenë në harmoni me Rezolutën, e cila është miratuar në Kuvend të Kosovës dhe të kemi një stabilizim të marrëdhënieve ndërshtetërore.

Petar Miletqi, në emër të Grupi Parlamentar SLS, tha se grupi që ai përfaqëson me vendosmërinë më të madhe mbështet të gjithë pjesëmarrësit e bisedimeve në mënyrë që sa më parë të arrihen rezultate nga këto bisedime.

Në vazhdim, ai theksoi se çështja e veriut të Kosovës dhe paralelizmi i institucioneve kërkojnë angazhim të madh, pragmatizëm dhe vendosmëri politike, ndërsa përgjegjësia e kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë në bisedimet e Brukselit, shikohet varësisht nga kualiteti i vendimeve të cilat ata do ti marrin. Më tej, ai u fokusua në kontributin që subjekti i tij politik ka dhënë në drejtim të formimit dhe funksionimit të komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës.

Ai në fund e vlerësoi edhe pjesëmarrjen e zëvendëskryeministrit dhe kryetarit të SLS-së si pjesë përbërëse e delegacionit të Republikës së Kosovës në bisedimet e Brukselit dhe shfaq bindjen se do të arrihen zgjidhje kualitative dhe të qëndrueshme në favor të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Lidhur me këtë pikë diskutuan edhe këta deputetë: Halit Krasniqi, Sadri Ferati, Alma Lama, Muhamet Mustafa, Shaip Muja, Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Vjosë Osmani, Rexhep Selimi, Teutë Sahaqija, Agim Kuleta, Arben Gashi, Visar Ymeri dhe Eqrem Kryeziu, si dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, dha sqarime lidhur me shqetësimet që i shtruan deputetët gjatë këtij debati, si dhe i falënderoi ata për kontributin e dhënë.

5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit

Kryetari e ftoi ministren për Integritet Evropian që para deputetëve ta prezantojë Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Ministrja Vlora Çitaku fillimisht tha se është hera e parë që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, hartojnë Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit

Në vazhdim, ajo tha se Republika e Kosovës është shteti i vetëm që nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në dhe se ky dokument rregullon obligimet e ndërsjella të BE-së me shtetet aspiruese për Integritet Evropian.

Më tej, ministrja e vlerësoi punën dhe kontributin e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, në procesin e avancimit të Kosovës drejt Integriteteve Evropiane.

Për të filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, duhet të zbatohen të gjitha marrëveshjet që dalin nga bisedimet ndërshtetërore Kosovë-Serbi, të cilat po mbahen nën mbikëqyrjen baroneshës Eshton, në Bruksel.

Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përbëhet nga 200 veprime, të cilat duhet të përmbushen dhe të cilat marrë në tërësi janë të sistemuara në dy periudha implementuese. Periudha e parë përmban objektivat në planin afatshkurtër, ndërsa periudha e dytë përmban përmbushjen e detyrave në planin afatmesëm.

Më tutje, ministrja i bëri një elaborim objektivave të cilat dalin nga ky Plan, ndërsa deklaroi se më 1 mars 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dërguar Komisionit Evropian, Raportin mbi përmbushjen e objektivave afatshkurtra.

Në fund, ajo konstatoi se institucionet e Republikës së Kosovës kanë përmbushur kriteret për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe këtë vit e konsideroi si vendimtar për këtë proces.

Ministrja i ftoi nga deputetët miratimin e Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit për Integritet Evropian, tha se si komision e kemi shqyrtuar Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime, me ndryshimet e propozuara.

Në vazhdim, ai e vuri theksin në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, për të cilën çështje tha se ka qenë një nga vërejtjet e cila me vite të tëra është theksuar në raportet e Komisionit Evropian dhe ftoi kryetarët e komisioneve parlamentare që në të ardhmen të fokusohen më shumë në këtë drejtim.

Deputeti Lutfi Haziri, në fund kërkoi nga deputetët miratimin e Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e të Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Blerta Deliu-Kodra, në emër Grupit Parlamentar të PDK-së; Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe deputetët: Zenun Pajaziti, Hykmete Bajrami, Liburn Aliu, Arben Gashi, Armend Zemaj dhe Lutfi Haziri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, bashkë me rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 44,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian.

6. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2013

Kryetari në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës tha se Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2013 paraqet dokument bazë të Kuvendit për aktivitetin e organit ligjvënës të Republikës së Kosovës. Ky program, tha ai, është hartuar duke u bazuar në këto dokumente:

- Dokumenti i Qeverisë për Strategjinë Legjislative për vitin 2013,
- Planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2013,
- Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2013.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit dhanë: Suzan Novobërdaliu, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; ndërsa Petar Miletiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe deputetët Sala Berisha-Shala, Agim Kuleta dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2013, bashkë me rekomandimet e Kryesisë së Kuvendit të datës 27 shkurt 2013.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2013.
2. Parashtrimi i projektligjeve nga Qeveria e Kosovës të bëhet sipas dinamikës kohore, që mundëson shqyrtimin e tyre në përputhje me procedurën e Kuvendit.
3. Projektligjet që parashtrihen nga Qeveria e Kosovës pas datës 31 tetor 2013, për shkak të afateve procedurale, nuk sigurohet se mund të miratohen në këtë vit kalendarik.
4. Agjencitë e pavarura, që i emëron Kuvendi, raportet e punës për vitin paraprak t'i procedojnë në Kuvend në afatin ligjor, ndërsa ato agjenci që nuk e kanë të paraparë kohën e raportimit me ligj, raportet e punës t'i dërgojnë në Kuvendit deri më 30 korrik 2013.
5. Koordinimi për zbatimin e Programit Legjislativ të Qeverisë së Kosovës dhe Programit Legjislativ të Kuvendit të bëhet nëpërmjet zyrtarëve përgjegjës të Zyrës Ligjore të ZKM-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale të Kuvendit.
6. Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale duhet ta informojë Kryesinë e Kuvendit për çdo muaj për parashtrimin e projektligjeve nga Qeveria e Kosovës, që janë paraparë me Programin Legjislativ të Qeverisë dhe të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Avokaturën Shtetërore.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funksional për Legjislacion, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Arben Gashi.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Avokaturën Shtetërore.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Kryetari e hodhi në votim amendamentin e propozuar në këtë projektligj.

Kuvendi e miratoi amendamentin nr. 1.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentin e miratuar, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit

Deputetja Suzan Novobërdaliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit tha se si komision e kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej, ajo u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit.

Deputetja Suzan Novobërdaliu, më pas paraqiti para Kuvendit rekomandimet të cilat janë paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL, të cilat kanë të bëjnë me: Afatin sa më të shkurtër për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër diskriminimit; FunkSIONalizimin e Qendrës për Trajtim të Barabartë, e cila, edhe pse e paraparë me këtë ligj, asnjëherë nuk është themeluar; Qeveria e Kosovës ta pezullojë strategjinë për zbatimin e këtij ligji deri në ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Kurtan Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Kymete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 17:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale